



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 64, paragrafi 1, pika 22 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 3/2002, 51/2003, 85/2003, 40/2004, 61/2005 dhe 129/2006) dhe nenit 172, paragrafët 1 dhe 8 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2007), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë mori:

VENDIM

për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve (tekst i konsoliduar jozyrtar)¹

I. DISPOZITA TË PËRGJITSHME²

1. Me këtë vendim përcaktohen kushtet dhe mënyra e punës së kursimoreve në Republikën e Maqedonisë, nga aspekti i:

- miratimit të kredive dhe ekspozimit;
- mjaftueshmërisë së kapitalit;
- investimeve;
- mbledhjes së depozitave;
- auditimit të brendshëm; dhe
- menaxhimit të rrezikut valutor.

II. MIRATIM I KREDIVE DHE EKSPOZIMI I KURSIMOREVE

¹ Kjo paraqet tekstin e konsoliduar jozyrtar të Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve. Teksti i konsoliduar jozyrtar i Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve përfshin Vendimin për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/07), Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/08) dhe Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/15).

² Në pikën 7 të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/15) është rregulluar që kursimoret janë të detyruara të harmonizohen me dispozitat e tyre deri më 31 dhjetor 2015. Me përjashtim të kësaj, dispozitat e pikes 5 të vendimit të njëjtë do të zbatohen nga dita e miratimit të kursimoreve me dispozitat e tyre deri më 31 dhjetor 2015.

2. Ekspozimi ndaj personit dhe personave të lidhur me të nuk duhet të kalojë 10% të mjeteve të veta të kursimores.

Ekspozimi ndaj aksionarit, përkatësisht ortakut me pjesëmarrje të kualifikuar në kursimore dhe personave të lidhur me të, nuk duhet të kalojë 5% të mjeteve të veta të kursimores.

Ekspozimi ndaj personit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe personave të lidhur me të nuk duhet të kalojë 3% të mjeteve të veta të kursimores.

Ekspozimi total ndaj personave të paragrafëve 2 dhe 3 të kësaj pike nuk duhet të kalojë 65% të mjeteve të veta të kursimores.

Ekspozimi total ndaj bankave dhe kursimoreve nuk duhet të kalojë 30% të mjeteve të veta të kursimores.

3. Ekspozimi ndaj personave të pikës 2, paragrafët 2 dhe 3 të këtij vendimi miratohet në bazë të vendimit të organit mbikëqyrës ose të kuvendit, përkatësisht të Kuvendit të ortakëve të kursimores.

Kushtet sipas të cilave miratohen kreditë, mbliidhen depozitat dhe bëhen transaksionet e tjera financiare me personat e pikës 2, paragrafët 2 dhe 3 të këtij vendimi, në nivel të barabartë rreziku të përcaktuar në përputhje me standardet mbikëqyrëse, nuk duhet të jenë më të favorshme sesa kushtet që vlejnë për klientët e tjerë të kursimores.

II-A. MJAFTUESHMËRI E KAPITALIT

4. Kursimorja është e detyruar të mbajë shkallën e mjaftueshmërisë së kapitalit që nuk mund të jetë më i ulët se 20%.

Kursimorja përcakton shkallën e mjaftueshmërisë së kapitalit me zbatimin e duhur të rregullores së Bankës Popullore për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Gjatë përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit, kapitali i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të përcaktuara në përputhje me rregulloren e paragrafit 2 të kësaj pike shumëzohet me 2,5.

III. INVESTIME NË KURSIMORE

5. Kursimorja nuk mund të fitojë tokë, ndërtesa dhe pajisje që nuk i përdor për kryerjen e veprimtarisë së saj, si dhe aksione kapitali në subjekte të tjera, me përjashtim të atyre të fituara në bazë të kërkesave të papaguara.

Prona e kursimores në tokë, ndërtesa dhe pajisje nuk duhet të kalojnë 30% të mjeteve të veta të kursimores.

Brenda kufirit të paragrafit 2 të kësaj pike nuk përfshihen prona në tokë, ndërtesa dhe pajisje të fituara në bazë të kërkesave të papaguara, e të cilat kursimorja nuk i përdor për kryerjen e funksioneve të saj, si dhe pjesët e kapitalit të fituara në bazë të kërkesave të papaguara.

Kursimorja është e detyruar të shesë pronën dhe pjesët e kapitalit të fituara në bazë të

kërkesave të papaguara brenda tre viteve nga fitimi e tyre. Në të kundërt, të njëjtat përfshihen në kufizimin sipas paragrafit 2 të kësaj pike.

6. Kursimorja është e detyruar të ketë politikë dhe procedura të shkruara që duhet t'i referohen procesit të fitimit dhe të shitjes së pronës së fituar në bazë të kërkesave të papaguara.

IV. MBLEDHJE E DEPOZITAVE

7. Kursimorja është e detyruar të vendosë në pikat e saj të pagesave dhe shlyerjeve kumtesën që nuk pranon depozita në valutë.

8. Kursimorja është e detyruar të ketë politikë dhe procedura të shkruara që rregullojnë të paktën mënyrën e mbledhjes, evidentimit dhe pagesës së depozitave, llogaritjen e interesit dhe ndarjen e detyrimeve.

V. AUDITIM I BRENDSHËM

9. Për kursimoret zbatohen dispozitat për mënyrën e organizimit dhe të kryerjes së auditimit të brendshëm të kreut IX, pjesës 6 të Ligjit të Bankave

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, nëse kursimorja nuk ka person - auditor të autorizuar në Shërbimin e auditimit të brendshëm, të paktën njëri nga të punësuarit në Shërbimin e auditimit të brendshëm duhet të ketë certifikatën e auditorit, të fituar në përputhje me ligjin.³

V-A. MENAXHIMI I RREZIKUT VALUTOR

9-A. Kursimorja është e detyruar të menaxhojë rrezikun valutor në mënyrën që korrespondon me natyrën, madhësinë dhe ndërlikueshmërinë e aktiviteteve që kryen.

Menaxhimi i rrezikut valutor të paragrafit 1 të kësaj pike duhet të mbulojë të gjitha aktivitetet dhe transaksionet e kursimores të shprehura në denarë me klauzolë valutore.

Gjatë menaxhimit të rrezikut valutor, kursimorja është e detyruar të respektojë udhëzimet dhe kërkesat e përcaktuara me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut valutor, të cilat i referohen krijimit të sistemit për menaxhimin e rrezikut valutor, kompetencave të organeve të kursimores gjatë menaxhimit të rrezikut valutor dhe miratimin dhe fushëveprimin e politikës dhe procedurave të duhura për menaxhimin e këtij rreziku.

³ Në pikën 7, paragrafi 3 të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/15) është rregulluar që dispozitat e pikës 9, paragrafi 2 të Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve do të zbatohen nga dita e harmonizimit të kursimores me këto dispozita deri më 31 dhjetor 2016.

Në aktet e brendshme për identifikimin, matjen, kontrollin ose zvogëlimin dhe monitorimin e rrezikut valutor, banka e kursimeve duhet të përcaktojë një ose më shumë tregues për monitorimin dhe kufizimin e ekspozimit ndaj rrezikut valutor.

Banka Popullore mund të kërkojë nga kursimorja të zbatojë tregues më të ndryshëm për ndjekjen dhe kufizimin e ekspozimit ndaj rrezikut valutore që kursimorja është e detyruar t'i respektojë.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

10. Kursimoret janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij vendimi brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi të tij.

11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon së vlefshmi Vendimi për përcaktimin e vëllimit dhe të mënyrës së funksionimit të kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 111/2000, 80/2002 dhe 66/2003).

12. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

**Guvernatori
Dhe kryetari i Këshillit të
Bankës Popullore të Republikës
së Maqedonisë
Mr. Petar Goshev**